

VENDIM
Nr. 1047, datë 4.12.2013

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT, SI
AUTORITET KONTRAKTUES, PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, ME
OBJEKT “BLERJE E PAJISJEVE PËR MIRËMBAJTJEN E SISTEMIT DATACOM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si autoritet kontraktues, për kryerjen e procedurave të prokurimit, me objekt “Blerje e pajisjeve për mirëmbajtjen e sistemit *datacom*”, me fond limit 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, me TVSH, të miratuar në buxhetin e vitit 2013.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama